

[Data 05/11/2024]

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “**BLERJE UNIFORMA DHE VESHJE SPECIALE PËR MZSH-NË**” - I NDARË NË LOTE SI MË POSHTË:

LOTI I PARË: “UNIFORMA ZJARRËDURUESE”

LOTI I DYTË: “VESHJE PUNE”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Veshjeve mbrojtëse dhe sigurie- 35113400-3; Xhaketa të sigurie 35113430-2; Çorape ose trikotazhe mbrojtëse 35113460-1; Këmisha ose pantallona mbrojtëse 35113470-4; Uniforma zjarr-fikësish 35811100-3

1. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **37,809,954 (tridhjetë e shtatë milion e tetëqind e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e katër)** leke pa TVSH, i ndarë në lote si më poshtë:

Loti 1: “Uniforma Zjarrëduruese”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratës: **27,880,050 (njëzetë e shtatë milion e tetëqind e tetëdhjetë mijë e pesëdhjetë)** lekë pa tvsh.

Loti i dytë - “Veshje Pune” me fond limit/vlera e pritshme e kontratës: **9,929,904 (nëntë milion e nëntëqind e njëzet e nëntë mijë e nëntëqind e katër)** lekë pa tvsh.

Burimi i financimit: Burimi i financimit: Vënë në dispozicion me anë të VKB-së Nr.125 datë 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2024” (i ndryshuar).

Marrëveshje Kudër me disa operatorë ekonomikë: 1 (një) operator ekonomik fitues për secilin lot (*Këtu, duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër*).

Një ofertues mund të aplikojë për: të gjitha lotet.

Kushtet që duhet të zbatohen në rastin e rihapjes së konkurrimit: (N/A)/ Nuk do të ketë rihapje konkurrimi.

Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër ose afati i zbatimit të kontratës: Afati kohor i parashikuar për Marrëveshjen Kuadër është 12 (dymbëdhjetë) muaj, për secilin lot.

Nga data e nënshkrimit të kontratës operatori fitues duhet të lëvrojë mallin sipas kërkesave dhe në datat e përcaktuara nga Autoritetit Kontraktor, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditë pune, për secilin lot. Lejohet lëvrimi i pjesshëm i mallrave, brenda këtyre afateve.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, për procedurën me objekt “**Blerje uniforma dhe veshje speciale për MZSH-në**” i ndarë në lote si më poshtë:

Loti 1: “Uniforma Zjarrëduruese”

Loti 2: “Veshje Pune”

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PËR:

LOTI 1: “UNIFORMA ZJARRDURUESE”

LOTI 2: “VESHJE PUNE”

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9; (për secilin lot)

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4; (për secilin lot)

c. Formularin e Ofertës Ekonomike, sipas Shtojcës 1 (për secilin lot)

d. Lista e çmimeve të artikujve sipas Shtojcës 3 (për secilin lot)

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9. (për secilin lot)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar **e ndarë sipas loteve duhet të jetë si më poshtë:**

Për Lotin 1, jo më e vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të lotit të parë që prokurohet, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Për Lotin 2, jo më e vogël se 40 % e vlerës së përllogaritur të lotit të dytë që prokurohet, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Shënim: PJESMARRJA NË MË SHUMË SE NJË LOT: Operatori ekonomik që do të ofertojë për më tepër se një Lot, duhet të zotërojë kapacitetet teknike, ekonomike dhe financiare sa shuma e loteve, për të cilat kanë ofertuar, të marra se bashku.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit/ vlera e pritshme e kontratës së përllogaritur për lot, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c dhe pika 5, si dhe neni 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i

ndryshuar.

Për Lotin 1: Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

Pika 2/a: dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;”. Vlera e përllogaritur **për Lotin 1** është mbi kufirin e lartë monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Për Lotin 2: Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

Pika 2/c: 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme..... Vlera e përllogaritur **për Lotin 2** është nën kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Neni 55, pika 4 të VKM nr. 285 ”Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në legjislativin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43, pika 5, “Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

2.2.2 Kopje të certifikuar të bilanceve të tre viteve të fundit 2021, 2022, 2023 të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilet plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e gërmes “c” të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009” Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore. **(për secilin lot)**

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Neni 43, pika 4, të VKM nr. 285 ”Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatorët ekonomik duhet të paraqesin dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë,
e ndarë sipas loteve duhet të jetë si më poshtë:

Për Lotin 1: jo më të vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës/lotit të parë, që prokurohet.

Për lotin 2: jo më të vogël se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës/lotit të dytë, që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Shënim: PJESMARRJA NË MË SHUMË SE NJË LOT: Operatori ekonomik që do të ofertojë për më tepër se një Lot, duhet të zotërojë kapacitetet teknike, ekonomike dhe financiare sa shuma e loteve, për të cilat kanë ofertuar, të marra se bashku.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenit 40/4, si dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Për Lotin 1: *Bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", citohet: "Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Për Lotin 2: *Në nenin 55, pika 4, të VKM nr. 285, citohet se: "Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë:*

- b) *Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të*

fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës dhe në rastin kur ai nuk është prodhues të paraqesë certifikatën përkatëse të prodhuesit/distributorit të autorizuar të mallrave objekt prokurimi, si më poshtë: **(për secilin lot)**

a) ISO 9001, për sistemin e menaxhimit të cilësisë;

b) ISO 14001:2015, ose e përditësuar lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40 dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e Autoritetit kontraktor të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra AK-së .

Për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik lidhur me përvojën e duhur, vërtetuar kjo edhe nëpërmjet dokumentave të tilla si çertifikata ISO e cila është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e kontratës.

ISO 14001 specifikon kërkesat e përgjithshme për vendosjen e një sistemi të menaxhimit mjedisor në një kompani. Ai përqendrohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të një kompanie duke e mundur atë për të përmirësuar ndikimin e performancës së përgjithshme mjedisore të kompanisë. Një organizatë mund të marrë dhe zbatojë certifikimin ISO 14001, pavarësisht nga madhësia ose qëllimi i saj. Sistemet e menaxhimit të mjedisit bazuar në ISO 14001 ofrojnë mundësinë për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar aspektet mjedisore të një organizate me qëllim :

- Parandalimit të dëmtimit të mjedisit;
- Vlerësimin të aspekteve mjedisore;
- Përmirësimin e performancës mjedisore;
- Respektimin e ligjeve;
- Ruajtjen e burimeve natyrore dhe uljen e kostos;
- Përmirësimin e imazhit të kompanisë;
- Përmirësimin e komunikimit me figurat e autoritetit.

2.4.2 Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, të materialeve përbërëse të produkteve të...

e ndarë sipas loteve si më poshtë:

Për Lotin 1: Uniformës zjarrduruese të personelit operues (zjarrfikës), përkatësisht *uniformës mbrojtëse nga zjarri (xhaketa dhe pantallonat), + Kapuçi mbrojtës për zjarrfikësin + Dorezat për mbrojtje nga zjarri.

Për Lotin 2: Veshjes së Punës përkatësisht *Kostum pune vere dok (xhaketë+pantallona+kapele, bluzë me mëngë të gjata dhe të shkurtra)

(Raporte testimi për copën e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë-analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta).

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 40, pika 6, gërma c) ku cilësohet se:

Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

2.4.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/et e prodhues/ve ose distributor/ve të autorizuar (në këtë rast duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një autorizimi mes tyre) për të gjitha mallrat objekt prokurimi për të cilat nuk është vetë prodhues. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit dhe/ose distributorit të autorizuar si: telefon, fax, email, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. **(për secilin lot)**

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë prodhuesit e të gjitha mallrave objekt prokurimi me të dhënat e kontaktit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht në dobi të përfituesve finale dhe produkteve/shërbimeve më cilësore, pra garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Loti 1

2.4.4 OE pjesëmarrës duhet të paraqesë certificate konformiteti të rregullores EU 2016/425 ose e

përditësuar, për uniformat zjarrëduruese (xhakete+pantallona+dorashka+helmet+cizme zjarrëfikëse+kapuc) sipas standarteve të mbrojtjes dhe sigurisë ndaj zjarrit të përcaktuara në specifikimet teknike të DST. Si edhe certifikatën e modulit D sipas rregullores EU 2016/425 lëshuar në emër të prodhuesit për produktet e tekstilit të kategorisë III. **(për Lotin 1)**

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40 dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në lidhje me këtë kriter, AK i është referuar një standarti ndërkombëtar, sikurse përcaktohet edhe në nenin 36 “Specifikimet teknike”, të LPP-së,....dhe kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve. Duke qenë se nuk ekziston një standart konkret kombëtar, pasi standartet e harmonizuara shqiptare të miratuara shërbejnë vetëm si dokumenta me karakter refererues për prezumimin e konformitetit të pajisjeve dhe i referohen direktivës 2016/425/EU, AK i referohet rregullores së re 2016/425/EU me anë të së cilës aplikohet për procedurë verifikimi dhe certifikimi të shoqërisë prodhuese, ku vlerësohet se në modelimin apo prodhimin e këtyre artikujve respektojnë kërkesat thelbësore të përcaktuara në rregulloren 2016/425/EU në të cilën përcaktohen kërkesat minimale që duhet të përmbajnë pajisjet mbrojtëse personale, në përputhje me kriteret e përcaktuara për të konfirmuar se pas ekzaminimit dhe certifikimit të shoqërisë, artikujt e prodhuar prej tij nuk rrezikojnë shëndetin ose sigurinë. Vendosja e një kërkesë të tillë është në përputhje me kriteret e përcaktuara për të konfirmuar se pas ekzaminimit dhe certifikimit të shoqërisë, artikujt e prodhuar prej tij nuk rrezikojnë shëndetin ose sigurinë e personave, kafshëve shtëpiake ose pronës (referuar rregullores). Kërkesa që artikujt objekt prokurimi të përmbushin kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara me rregulloren EU nr 425/2016 është vendosur pasi këto veshje janë prodhim për përdorim pune nga punonjës institucioni në shërbim komuniteti dhe mbrojtje të jetës (pra jo përdorim personal), të cilët përballen me situatat të ndryshme vështirësie, përfshirë kushtet atmosferike që nuk janë të një natyre ekstreme apo kontakti me sipërfaqe të nxehta që nuk i kalojnë 50 gradë Celsius (referuar kategorive të vështirësisë të përcaktuara në rregulloren EU nr. 425/2016). Gjithashtu AK në specifikimet teknike të përgatitura nga specialistë të fushës janë vendosur edhe standartet SSH/EN për artikujt përkatës.

Loti 2

2.4.4 Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatë OEKO-TEX “ose ekuivalente” (të vlefshme), për tekstilet të prodhuesit të lëndës së parë, për tekstilet e produkteve të të gjitha veshjeve të punës. Në rastin kur lëndët e para sigurohen nga prodhues të ndryshëm, certifikata ose dokumenti ekuivalent me të, duhet të paraqitet për të gjithë prodhuesit. Për këtë OE pjesëmarrës duhet të paraqesë një autorizim nga prodhuesi i lëndës së parë ku të bëhet lidhja midis prodhuesit dhe OE/distributorit të autorizuar. **(për Lotin 2)**

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40 dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Referuar specifikimeve teknike të kësaj procedure prokurimi, Njësia e prokurimit gjykon se është e domosdoshme paraqitja e certifikatës OEKO-TEX, pasi lënda e parë e prodhuar nga subjekte të certifikuara sipas këtij standarti garanton se lënda e parë e përdorur është e padëmshme në aspektin ekologjik njerëzor, pra nuk mbart substance të dëmshme për shëndetin e njeriut.

STANDARD 100 nga OEKO-TEX® është një nga etiketat më të njohura në botë për tekstilet e testuar për substanca të dëmshme. Ai garanton besimin e klientit dhe sigurinë e lartë të produktit.

Nëse një artikull tekstili mban etiketën STANDARD 100, konfirmon se çdo përbërës i këtij artikulli, d.m.th. çdo fije, buton dhe pajisje të tjera, është testuar për substanca të dëmshme dhe se artikulli është i padëmshëm për shëndetin e njeriut. Testi kryhet nga institutet partnere të pavarura OEKO-TEX® në bazë të katalogut të gjerë të kriterëve OEKO-TEX®.

2.4.5 Operatori ekonomik për të asistuar stafin e AK gjatë procesit të prodhimit/ qepjeve/ përmasave apo modifikimeve për realizimin e uniformës së punonjësit të shërbimit zjarrfikës, duhet të ketë në stafin e tij:

Për Lotin 1: jo më pak se 10 (dhjetë) punonjës për 3 muajt e fundit

Për Lotin 1: jo më pak se 5 (pesë) punonjës për 3 muajt e fundit

Shënim: ***Kriteri 2.4.5 konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese. Këto dokumenta duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5 “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit...”, si dhe pika 8 “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me këto kërkesa. Në këtë kontekst, referuar natyrës, vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij si me lart, e cila është vendosur në përputhje me specifikimet teknike për këtë procedurë, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me kapacitetet teknike dhe aftësitë profesionale të operatorëve.

Objekti i procedurës së prokurimit “Uniforma dhe veshje speciale” përfshin në vetvete edhe procesin e prodhimit të uniformës së MZSH-së, Shërbimit Zjarrfikës, pra përmban në vetvete elemente shërbimi për të cilën është e nevojshme që nga ofertuesit e mundshëm ekonomike të disponohet edhe një staf i cili të bëjë të mundur realizimin me sukses të këtij procesi për realizimin e uniformës së punonjësit të shërbimit zjarrfikës me anë të së cilës ata përfaqësojnë institucionin e Bashkisë Tiranë. Specialistët/ punonjësit e kërkuar janë të nevojshëm për procesin e prodhimit/ qepjeve apo modifikimeve në rast se do të jetë e nevojshme të mallrave objekt prokurimi.

Kërkesa nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.”.

2.4.6 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera këto pajisje: **(për secilin lot)**

❖ 1 (një) makineri qëndisje;

- ❖ 1 (një) linjë stampimi me serigrafi (makineri stampimi, furrë tharje stampimi dhe presë për ngjitjen e logove)

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre ose marrjen me qera të tyre: (faturë tatimore të shitblerje/aktet e zhdoganimit, origjinale ose fotokopje të noterizuar, ose cdo lloj akti tjetër ligjor që vërteton pronësinë ose kontratë qeraje të noterizuar). Për makineritë me qera duhet të përgatitet kontrata e qerasë e lidhur para noterit, me afat për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi, e shoqëruar me dokumentacionin që vërteton pronësinë e qeradhënësit (fatura tatimore ose zhdoganimi ose cdo lloj tjetër ligjor që vërteton pronësinë e qeradhënësit).

Shënim: ***Kriteri 2.4.6 konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese. Këto dokumenta duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Referuar specifikimeve teknike dhe kërkesave të percaktuara nga Autoriteti Kontraktor për realizimin e këtij objekti prokurimi dhe realizimin e proceseve të punës sa më sipër cituar lind e nevojshme edhe disponimi i makinerive të kerkuara duke qënë se vetë projekti është një ndërthurje e zërave të mallit me ato të shërbimit sikundër janë procesi i dizenjimit dhe prodhimit të uniformës së MZSH-së, Shërbimit Zjarrfikës, ndaj është e nevojshme që nga ofertuesit e mundshëm ekonomike të disponohen edhe pajisjet/ makineritë për të bërë të mundur realizimin me sukses të këtij procesi për realizimin e uniformës. Pajisjet/ makineritë e kerkuara janë të nevojshme për procesin e prodhimit/ qepjeve apo modifikimeve në rast se do të jetë e nevojshme të mallrave objekt prokurimi.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.4.7 Operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë të paketuara dhe të protokolluara mostra për të gjithë artikujt objekt prokurimi, si më poshtë: **(për secilin lot)**

- a) nga një mostër fizike për objektet e uniformës (produkt të gatshëm) që do të prokurohen që përfshin të gjitha detajet, llojin e materialit dhe pjesëve përbërëse të tyre, punimin dhe përmasat e caktuara në specifikimet teknike. *Mungesa e mostrës dhe e lëndës së parë që shoqëron ato është kusht s’kualifikues.*
- b) Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave pranë Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Prokurimeve Administrative dhe Shërbimeve, Bashkia Tiranë, me adresë: Sheshi Skënderbej, Nd. 2”, Tiranë.
- c) Mostrat e paraqitura duhet të kenë të trupëzuar një etiketë të qepur, e cila të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, Objektin e Porcedurës/ Lotin për të cilin oferton, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e prodhuesit/ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik, të identifikueshme me numrin rendor përkatës në etiketë *(sipas numrit rendor të tabelave, psh: Loti 1: Nr.1- Uniformë zjarrduruese, referuar “Shtojca 3”/ shtojcës 6/ Loti 2: Veshje Pune, Nr.1- Kapele, referuar “Shtojca 3”/ shtojcës 7).*

- d) Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e kontrollit të mostrave të sjella me përputhshmerinë e specifikimeve të kërkuara dhe të kryejë analizat e nevojshme laboratorike nëse do të shihet e arsyeshme.

Mosparaqitja e mostrave sipas kërkesave të mësipërme përbën kusht s'kualifikimi për vazhdimin e procedurave.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 40, pika 6, gërma a) ku cilësohet se: Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi., lidhur me të gjitha detajet, llojin e materialit dhe pjesëve të tyre, punimin dhe përmasat e caktuara në specifikimet teknike. Nëpërmjet mostarve të dorëzuara, Autoriteti Kontraktor mund të kryej kontrollin e mostrave të sjella me përputhshmerinë e specifikimeve të kërkuara dhe të kryejë analizat e nevojshme laboratorike nëse do e sheh të arsyeshme.

Shënim: 1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s'kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s'kualifikimi.

2. Referuar nenit 82, pika 4 e ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 për “Prokurimin publik”, I ndryshuar, “Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë”, si dhe Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, “Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e

dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur

3. “Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim.”

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave për procedurën me objekt **“Blerje uniforma dhe veshje speciale për MZSH-në” për të dy lotet Loti 1: “Uniforma Zjarrëduuese”; Loti 2: “Veshje Pune”, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 1, 2 dhe 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

Argumentimi, sipas materialit të përgatitur nga struktura e posaçme:

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “d”, dhe nenit 64, shkronja “a” të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar); Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për “Menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar); nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); nenit 76 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar); VKB-së nr. 125 datë 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2024”; grupi i punës hartoi specifikimet teknike për realizimin e objektit: **“Blerje uniforma dhe veshje speciale për MZSH-në” për të dy lotet Loti 1: “Uniforma Zjarrëduuese”; Loti 2: “Veshje Pune”, duke përcaktuar qartë kërkesat e Autoritetit Kontraktor.**

Bazuar në specifikimet teknike të miratuara dhe hartuara nga struktura e ngarkuar për këtë qëllim, Grupi i punës vendosi të ribëj studimin e tregut (për arsye të ndarjes në lote të procedurës së prokurimit), për çmimin e uniformës zjarrëduuese dhe veshjeve të punës për punonjësit e shërbimit zjarrëfikës, mbi bazën e të cilës përcaktohet fondi limit për procedurën e prokurimit për secilin lot. Pas identifikimit të subjekteve që operojnë në fushën e aktivitetit të objektit që prokurohet, kërkesa për përllogaritjen e fondit limit me qëllim llogaritjen e vlerës së kontratës, ju dërgua 3 subjekteve, në përputhje me kërkesat teknike të përgatitura nga komisioni i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Tiranë “Për krijimin e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën **“Blerje uniforma dhe veshje speciale për MZSH-në” për të dy lotet Loti 1: “Uniforma Zjarrëduuese”; Loti 2: “Veshje Pune”**

Grupi i punës i përbërë nga specialistë të fushës, i ngritur urdhër të Titullarit të AK Bashkia Tiranë, në zbatim të detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, pas identifikimit të nevojave që kanë punonjësit e shërbimit zjarrëfikës pranë strukturave të MZSH-së, përgatiti specifikimet teknike dhe relacionin prezantues për realizimin e investimit.

Specifikimi i parametrave teknik, materialeve etj:

Termet e referencës dhe kërkesat funksionale/ specifikimet teknike hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(I ndryshuar), për përmbushjen e qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:

Qëllimi i këtij investimi është kompletimi me uniforma për Drejtorinë e MZSH-së bazuar në VKB-në 82, datë 20.07.2023, në zbatim të VKM-së nr. 1153, datë 24.12.2020 për “Miratimin e uniformës, shenjave dalluese përkatëse, flamurit dhe stemës së shërbimit të mbrojtjes nga zarri dhe shpëtimi”, për mbarëvajtje të punës në shërbim të komunitetit nga strukturat e këtij institucioni për përballimin e situatave të zjarrit, emergjencave të ndryshme, eliminimin e pasojave të përmbytjeve dhe rasteve me rrezik të shtuar.

Të gjitha specifikimet janë hartuar referuar VKB-së 82, datë 20.07.2023, në zbatim të VKM-së nr. 1153, datë 24.12.2020 për “Miratimin e uniformës, shenjave dalluese përkatëse, flamurit dhe stemës së shërbimit të mbrojtjes nga zarri dhe shpëtimi”.

Shënim: Autoriteti Kontraktor menjëherë pas lidhjes së Kontratës me Operatorin ekonomik të shpallur fitues, do të japë përmasat që duhen për punonjësit e MZSH-së. Operatori ekonomik mban përgjegjësi dhe garanci për produktin e ofruar. Ndalohet shumëfishimi dhe realizimi i modeleve e ngjyrave të tyre për përdorues të institucioneve apo subjekteve të tjera që trajtohen me uniformë, të cilat nuk kanë të njëjtin mision dhe detyra që ka Drejtoria e MZSH-së.

Mostrat e sjella nga prodhuesi e të vlerësuara nga përdoruesi (porositësi), të depozituara sipas përcaktimeve, do të shërbejnë si bazë për prodhim.

Argumentimi: Specifikimet teknike të mallit objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për veshje me uniforma dhe elemente të tjerë sigurie sipas standarteve të miratuara dhe unifikuara për punonjësit e MZSH-së dhe që janë shumë të rëndësishme për punonjësit gjatë punës së tyre. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

Sa më sipër, specififikimet teknike, janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Specifikimet teknike janë hartuar bazuar në veshjen uniformë të miratuar për punonjësit e MZSH-së. Në specififikimet teknike të secilit prej artikujve pjesë përbërëse e uniformës përkufizohen karakteristikat e produktit dhe mënyrës së prodhimit të tyre, siç janë niveli i cilësisë, përshkrimi i të gjitha kushteve që duhet të plotësojë produkti i prodhuar, duke përfshirë edhe vlerësim të përputhshmërisë së lëndës së parë të përdorur dhe produktit final, forma dhe përmbajtja, niveli i sigurisë dhe dimensione, përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, llojet e materialit, ngjyrës, vlerat e qëndrueshmërisë së ngjyrës, përmasat etj procese dhe metodat të domosdoshme për prodhimin e tyre në secilën fazë, në mënyrë që operatorët ekonomikë të interesuar, të kenë informacion të plotë mbi prodhimin e produktit dhe të kenë mundësi të përmbushin kushtet e kriteret sipas specifikimeve të hartuara nga AK.

Këto modele pjesë e uniformës janë parashikuar të kenë kohëzgjatje të caktuar sipas normave të harxhimit të uniformave dhe sipas të njëjtit standard me veshjet ekzistuese në përdorim. Veshjet e uniformës dhe pjesët përbërëse të saj, përfshirë aksesorët pjesë e pandashme e pamjes së uniformës, duhet të jenë detyrimisht sipas specifikimeve të kërkuara, në mënyrë që punonjësit e MZSH-së të kenë prezencë dinjitoze dhe autoritetin e punonjësit të Shërbimit Zjarrfikës, sipas standartit të miratuar. Këpucët duhet të jenë detyrimisht sipas specifikimeve të kërkuara në mënyrë që punonjësit gjatë orarit të punës të jenë komode dhe të rehatshme për shkak të përditshmërisë së punës që punonjësit e MZSH-së kanë në terren.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, kërkesa të tjera të veçanta, specififikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Blerje uniforma dhe veshje speciale (MZSH)”** për të dy lotet , **Loti 1: “Uniforma Zjarrëduruese”**; **Loti 2: “Veshje Pune”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverballi:

Dokumentat e tenderit

NJËSIA E PROKURIMIT